



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
SEKRETARIATI

**Njoftim për Shtyp**

**(05 Korrik 2007)**

**Mbi kërkesën për autorizimin e njoftimit të përqëndrimit të kontrollit të përbashkët të aksioneve të Bankës Italiane të Zhvillimit nga disa shoqëri**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është paraqitur një kërkesë për njoftimin e përqëndrimit të shitjes së një pjese të aksioneve të Bankës Italiane të Zhvillimit sh.a. Tiranë, nga aksioneri Francesco Mariano Mariano tek NEREO FINANCE S.A. dhe CERERE S.r.l..

Sipas dokumentacionit të paraqitur, shoqëria NEREO FINANCE S.A. kërkon të zotërojë 37.00 për qind të aksioneve të Bankës Italiane të Zhvillimit. Shoqëria CERERE S.r.l. është e regjistruar në Itali dhe kërkon të zotërojë 18.00 për qind plus 2 aksione të Bankës. Struktura e aksionerëve të Bankës Italiane të Zhvillimit, në qoftë se do të miratohet ky përqëndrim, do të jetë:

Nereo Finance S.A.	37.00 %
Cerere S.r.l.	18.00 % + 2 aksione
Generali S.p.A.	10.00 % - 1 aksion
Banka Podravska d.d.	10.00 % - 1 aksion
Francesco Mariano Mariano	20.00 %, dhe
Banca Popolare Pugliese	5.00 %

Shoqëria NEREO FINANCE S.A. është e regjistruar në Luksemburg në regjistrin tregtar të kompanive dhe në autoritetet e tatim-taksave të Luksemburgut. Adresa e shoqërisë është: 38 Avenue de la Faiencerie, L – 1510, Luksemburg. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë, ndër të tjera, është blerja e pjesëmarrjeve sipas të gjitha formave që ekzistojnë, për të gjitha shoqëritë luksemburgeze ose të huaja.

Shoqëria CERERE S.r.l. është e regjistruar në Itali në Dhomën e Tregtisë, Industrisë, Artizanatit dhe Bujqësisë të Triestes si edhe në Agjencinë e të Ardhurave të Triestes. Selia e shoqërisë është në Trieste (TS), via Torrebianca 43, Itali. Kjo shoqëri ka për objekt të veprimtarisë së saj, ndër të tjera, tregtinë me shumicë, importimin, eksportimin, kalimin tranzit të produkteve bujqësore, të fruta-perimeve dhe të agrumeve, të produkteve ushqimore. Gjithashtu shoqëria ka për objekt edhe ushtrimin e çdo lloji veprimtarie financiare; blerjen, shitjen dhe administrimin e pasurive të paluajtshme, blerjen, shitjen dhe

administrimin e shoqërive, ushtrimin e veprimtarisë së “Factoring” dhe “Leasing”.

Autoriteti i Konkurrencës do ta shqyrtojë përqëndrimin mbështetur në nenin 10, 12, nenet për procedurat e kontrollit të përqëndrimeve(53-64), të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Autoriteti i Konkurrencës është i interesuar të dijë opinionet e mundshme dhe do të marrë në konsideratë çdo koment për këtë kërkesë.

Komentet me shkrim mund të adresohen në adresën:

Autoriteti i Konkurrencës  
Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut  
Rruga “Sami Frashëri”, nr.4, kati IV  
Tiranë, Shqipëri  
[www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al)  
[competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)